



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:257751
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05504938

C.nr.2469/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.B. me numër personal, nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av.S.K. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 7,615.89 euro, jashtë seancës, më datë **26.03.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses V.B. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, **DETYROHET** e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 01.11.2018 deri më datë 21.11.2022 apo për 48 muaj e 21 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, si dhe për 21 ditë, shumën prej 38.75 € në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **2,695.55 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 17.11.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses V.B. nga Prizreni, përkatësisht shuma prej **4,920.34 euro**, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 31.10.2018, si dhe diferenca mbi shumën e aprovuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për periudhën 01.11.2018 deri më datë 21.11.2022.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 164.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja V.B. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.S.K. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 7,615.89 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse pranë ShFMU “Abdyl Frashëri” në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Paditësja ka të kryer fakultetin e edukimit, nga ku ka marrë titullin bachelor i programit fillor, po ashtu e njëjta është i licencuar nga Ministria e Arsimit, andaj në bazën e kësaj i takon kompensimi për avancimin në karrierë dhe zhvillim profesional nga neni 7 par 1 pika 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit. E paditura edhe përkundër obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, e njëjta nuk i ka përmbushur obligimet ndaj paditësit në kompensimin në emër të kualifikimit. Paga bazë e paditësit është në lartësi prej 421 euro. Meqë e paditura nuk i ka përmbushur obligimin e saj ndaj paditëses, në kuptim të nenit 7 të KKA-së, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses, të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kualifikimit tia bëjë kompensimin në 27% të një page bazë që nga data 18.04.2017 deri me datë 22.01.2021 dhe 10% të pagës nga data 22.01.2021 e deri në përpilimin e ekspertizës me ekspertin financiar, me kamat ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me parashtresën e datës 09.11.2023, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka bërë precizimin e kërkesëpadijës, duke kërkuar kompensimin në emër të kualifikimit apo licencimit nga data 18.04.2017 deri me datë 21.11.2022, në lartësi prej 27% të pagës bazë, për 67 muaj, për secilin muaj nga 113.67 euro, në shumën e përgjithshme prej 7,615.89 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësja nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditëses. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja V.B. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë ShFMU “Abdyl Frashëri” në Prizren. Mirëpo,

kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër të protokollit 290/204 të datës 01.09.2015 e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, nga vërtetimi me numër 193/1 i datës 16.06.2021, lëshuar nga drejtori i SHFMU “Abdyl Frashëri”, rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura mësimdhënëse që 15 vite, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës-Qendra në Prizren, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1356, e datës 08.01.2016, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit- Qendra në Prizren, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i i programit fillor. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës nr. 290/204 të datës 01.09.2015, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësi përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësi

përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumë prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t'ia paguaj shumë prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 48 muaj e 21 ditë, nga data 01.11.2018 e deri më datë 21.11.2022, në shumë të përgjithshme prej **2,656.80 euro** ($48 \times 55.35 = 2,656.80$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor 2022 është 38.74 sipas $(55.35/30 = 1.845 \times 21 \text{ ditë} = 38.75)$ $2,656.80 + 38.75 = 2,695.55$ euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumë përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 17.11.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 08.11.2021, ndërsa kërkesa e saj ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 31.10.2018. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 18 muaj, e në shumë prej 2,046.05 € sipas $(113.67 \times 18 = 2,046.05)$ ndërkaq pjesa tjetër për 9 ditë është refuzuar për shkak se muajin Nëntor të vitit 2022 paditësja e ka llogaritur muaj të plotë edhe përkundër faktit se e ka kërkuar kompensimin deri me datë 21, andaj gjykata i ka refuzuar 9 ditë të muajit Nëntor 2022, $(113.67/30 = 3.789 \times 9 \text{ ditë} = 34.10)$. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar të pa bazuar pretendimet e paditëses lidhur me lartësinë e kompensimit, pasi që nga provat e paraqitura në padi konkretisht nga lista e pagave gjykata ka vërtetuar faktin se paditëses i është kompensuar nga e paditura një pjesë e shumës në emër të kualifikimit dhe atë 58.32 euro për çdo muaj, për periudhën 01.11.2018 deri 22.11.2022 respektivisht për 48 muaj e 21 ditë sipas $(48 \times 58.32 = 2,799.37)$ dhe për 21 ditë shuma prej 40.82 euro, pra shuma e refuzuar është $(2,046.05 + 34.10 + 2,799.37 + 40.82 = 4,920.34)$ mbi këtë bazë gjykata refuzoi pjesën e kërkesëpadisë së paditëses, në shumë të përgjithshme **prej 4,920.34 euro**.

Me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 17.11.2021 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.11.2018 e deri më 21.11.2022, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 17.11.2021 gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin nëntor 2018, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin nëntor 2018 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht e njëjta pas pranimit të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit për muajin nëntor 2018 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht dhjetor 2018, e njëjta ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”, rrjedhimisht këtu paditësja nga fillimi i muajit dhjetor 2018 ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura, e që nënkupton se padia e paditëses për periudhën 01.11.2018 e deri më 21.11.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi

pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën I-të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 164.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 60 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.2469/2021, më datë 26.03.2024

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.